



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT

RELACION

PËR NJË SHITESË NË VKB NR.77, DATË 29.12.2020, "MBI MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARA UNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021"

Të nderuar zotërinj këshilltarë!

Këshilli Bashkiak me **vendimin 77 date 29.12.2020**, "Mbi miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2020-2021", ka miratuar listën e nxënësve, të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe janë përfitues të bursës si dhe përfitimeve të tjera, të parashikuara në VKM nr.666, datë 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike".

Në Drejtorin Arsimore, Bashkia Berat ne muajin janar janë paraqitur kërkesat për burse nga nxënësit:

1. Ergi Gazment Merdani nxënës në shkollën e mesme profesionale "Stiliano Bandilli" me kohë të plotë, në klasën e X-të. Kërkon të trajtohet me bursë të plotë sipas kriterit "Nxënës të pakicë rome dhe egjiptiane", kërkesa me nr.48 prot date 20.01.2021.
2. Arjan Shemuni nxënës në shkollën e mesme profesionale "Stiljano Bandilli" në klasën e XI-të. Kërkon të trajtohet me bursë të plotë sipas kriterit "Ekonomik" pasi ka qenë ish përfitues vitin 2019-2020, kërkesa me nr.119 prot date 08.02.2021.
3. Fatjon Dudushi nxënës në shkollën e mesme profesionale "Stiliano Bandilli" në klasën e XII-të. Kërkon të trajtohet me bursë të plotë sipas kriterit "Jo ekonomik" "Nxënës fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit", pasi ka qenë ish përfitues për vitin 2019-2020. Kërkesa me nr.118 prot date 08.02.2021.
4. Erdion Kaceli nxënës në shkollën e mesme të futbollit "Loro Borici" klasa X-të. Kërkon të trajtohet me bursë të plotë sipas kriterit "Ekonomik" pasi nxënësi është i akomduar në konviktin "Mjeshtëria Sportive" Kamëz. Kërkesa me nr.120 prot date 08.02.2021.
5. Andrea Adnant Papa nxënës në shkollën e mesme profesionale "Stiliano Bandilli" në klasën e XI-të. Kërkon të trajtohet me bursë të plotë sipas kriterit "Jo ekonomik" "Nxënës fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit", pasi ka qenë ish përfitues për vitin 2019-2020. Kërkesa me nr.124 prot date 09.02.2021.
6. Iljas Haxhi Xhaxho nxënës në shkollën e mesme profesionale "Stiliano Bandilli" në klasën e XI-të. Kërkon të trajtohet me bursë të plotë sipas kriterit "Jo ekonomik"

“Nxënës fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit”, pasi ka qënë ish përfitues për vitin 2019-2020. Kërkesa me nr. 125 prot datë 09.02.2021

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia “Covid 19” këta nxënës nuk arritën të sjellin në kohë gjithë dokumentacionin e nevojshëm ndaj kërkesat janë paraqitur jashtë afateve ligjore, që përcaktonte njoftimi i bërë nga Drejtoria Arsimore Bashkia Berat, me nr 861 prot datë 13.11.2020.

Mbeshtetur në VKM 666 pika 33 “Vendimet e këshillave të njësive të vetqeverisjes vendore, në raste të vecantamund të miratohen përtej këtij afati vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin parauniversitar apo për arsimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore përkatëse”.

Me shkresë nr.983 datë 06.01.2021, Drejtoria e Arsimit Bashkia Berat i ka kërkuar Ministrise së Financave dhe Ekonomisë konfirmimin për shtyrjen e afatit të miratimit të bursës për nxënësit që mund të paraqesin dokumentat jashtë afateve ligjore dhe ka marrë konfirmimin nga MFE nepermjet Urdherit nr 15 , dt 27.01.2021

Komisioni i ngritur me Urdher nr.763 datë 30.10.2020 për “Verifikimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit për bursat e nxënësve të arsimit parauniversitar” pasi shqyrtoi dosjet vlerësoi se nxënësit e mesiperm plotesojnë kriteret për të përfituar bursë të plotë vitin shkollor 2020-2021.

Nga sa ju argumentuam më sipër kërkojmë nga Këshilli Bashkiak që të miratohen bursat e plota për nxënësit:

Nr	Emer Mbiemer	Shkolla	Klasa	Kriteri	Shenime
1	Ergi Gazment Merdani	“Stiliano Bandilli”	X	“Nxënës të pakicë rome dhe egjyptiane”	Aplikant i ri
2	Arjan Edmir Shemuni	“Stiliano Bandilli”	XI	“Ekonomik”	Ish përfitues
3	Fatjon Agron Dudushi	“Stiliano Bandilli”	XII	“Nxënës fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit”	Ish përfitues
4	Erdion Fatos Kaceli	“Loro Borici”	X	“Ekonomik”	Aplikant i ri
5	Andrea Adnant Papa	“Stiliano Bandilli”	XI	“Nxënës fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit”	Ish përfitues
6	Iljas Haxhi Xhaxho	“Stiliano Bandilli”	XI	“Nxënës fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit”	Ish përfitues

Drejtore

Klodiana Hoxha

